



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>DPKI</u>	Br. Prot. <u>06-1722/20</u>
Nr. I faq.	Prot. No.
Broj stranica <u>02</u>	Data
Nr. pages	Datum <u>21-08-2020</u>
	Date
	PRISHTINE



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 20.08.2020, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPKI-06-2843/19*, për zyrtarin e lartë publik z. Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë - Dega në Deçan, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për zyrtarin e lartë z. Bekim Avdimetaj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Deçan, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Avdimetaj krahas ushtrimit të funksionit si zyrtari i lartë publik, respektivisht, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Deçan, njëkohësisht ishte edhe si përfaqësues i autorizuar në biznesin privat “Bekim Avdimetaj” B.I.

Për t’i vërtetuar dyshimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare me numër DPKI-06-2564/1 është konstatuar se z. Avdimetaj mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare nr. AKK-DPKI-06-155/20, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.



Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Avdimetaj, i njëjti ka kontaktuar Agjencinë kundër Korrupsionit për tu sqaruar lidhur me situatën e konfliktit të mundshëm të interesit. Me këtë rast, Agjencia e ka njoftuar për papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik, konkretisht me atë se gjatë ushtrimit të funksionit si gjyqtar, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”.

Pas kësaj, zyrtari i lartë z. Avdimetaj, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare *DPKI-06-155-1/20*, me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Avdimetaj ka bërë shuarjen e biznesit në të cilin ka qenë person i autorizuar.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Avdimetaj, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip HAVOLLI
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

